

Udhëzime terapeutike për trajtimin e skabies (zgjebes)

Të dashur prindër, të dashur pacientë,

tek ju apo tek fëmija është konstatuar infektimi nga parazitët e zgjebes dhe për terapimin e skabies (zgjebes), infektion ky i shkaktuar nga parazitët e lëkurës, mjeku juaj j'u ka rekomanduar të merrni tabletat ivermectin-biomo 3 mg. Në gjuhën shkencore infektimi nga parazitët e zgjebes quhet edhe skabies. Për ta trajtuar këtë sëmundje me sukses dhe në mënyrë të shpejtë ju lutemi të ndiqni rekomandimet e mjekut tuaj si edhe informacionet e përgjithshme në vijim.

Çfarë është skabies?

Parazitët e skabies kanë një madhësi prej rreth 0,3 - 0,4 mm. Me nofullat e tyre të forta ata zhbirojnë kanale të vogla në shtresën e sipërme të lëkurës së njeriut. Zona të caktuara të trupit, si p. sh. duart dhe këmbët, pjesa e përparme e bërrylit apo zonat gjenitale, janë zonat e preferuara të këtyre parazitëve. Në pjesët e infektuara shkaktohen kruajtje të forta, sidomos gjatë natës në ngrohtësinë e shtratit. Me sy të lirë apo me një lente, mund të dallohen kanalizime të parregullta, shpesh në formë presjeje. Si pasojë e reaksionit ndaj infeksionit dhe prej kruajtjes në pjesën e prekura, krijohen zakonisht nyje në formë të stërzgatur ose edhe flluska, të cilat me kalimin e kohës mund të krijojnë kore. Nëse ju apo fëmija juaj jeni të prekur nga paraziti i skabies, kjo zakonisht nuk është pasojë e mungesës së higjienës personale. Paraziti nuk bën dallim në moshën, pastërtinë apo pozicionin shoqëror të njerëzve. Megjithatë, marrja e masave higjienike është shumë e rëndësishme, nëse ju dëshironi të çliroheni një herë e mirë nga kjo e keqe. Udhëzime për këtë do të gjeni në tekstin në vijim.

Si ndodh transmetimi i skabies?

Paraziti i skabies transmetohet përmes kontaktit të drejtpërdrejtë të lëkurës nga njëri person te tjetri. Shfaqja e simptomave te para ndodh zakonisht 2-6 javë pas transmetimit, në rastin e infektimit rishtas edhe më pak. Kryesisht në ambientet dhe institucionet e kolektive, si p.sh. në shkolla, kopshte fëmijësh, azilet e apo shtëpitë e pleqve, mund të jetë e shpeshtë shfaqja e këtyre rasteve. Kjo vlen veçanërisht, kur mjediset e fjetjes janë të përbashkëta. Në raste të rralla është i mundur edhe transmetimi përmes shtrojave të shtratit, tapicerisë apo batanijeve. Parazitët e skabies mund të mbijetojnë 3-4 ditë jashtë trupit, në temperatura të ulëta dhe të lagështa edhe më gjatë.



Si ta përdorni ivermectin-biomo 3 mg

Tabletat ivermectin-biomo 3 mg me përbërësin aktiv ivermectin dozohen individualisht sipas peshës trupore (0,2 mg për kg peshë trupore). Mjeku juaj ose farmacisti juaj do të përlllogarisë numrin e nevojshëm dhe do t'ju tregojë se sa tableta duhet të merrni.

Kapërdini numrin e tabletave që ju ka përshkruar mjeku juaj të shoqëruar me ujë dhe me stomakun bosh. Mos hani asgjë për dy orë para ose pas marrjes së tabletave, pasi nuk dihet se si ndikon ushqimi në absorbimin e ilaçit në trup.

Për fëmijët nën 6 vjeç, tabletat duhet të shtypen përpara se të gëlltiten.



Kur duhet t'i merrni tabletat?

Tabletat mund të merren në çdo kohë të ditës. Merrni numrin e tabletave të llogaritura për ju, me stomakun esëll. 24 pasi të keni marrë medikamentin, ju mund të shkoni sërish në punë ose fëmijët mund të vijnë në kopsht ose shkollë.

Çfarë duhet të dini përpara se të merrni ilaçin?

Mbani thonjtë e duarve dhe të këmbëve sa më të shkurtër të jetë e mundur dhe i pastroni ata me kujdes. Thonjtë e gjatë mund ofrojnë vend fshehje për parazitët e zgjebes.



Cilat janë masat e tjera higjienike të rëndësishme për suksesin e terapisë?

Ndërrimi i teshave

Vishni patjetër tешa të pastra në të njëjtën kohë që do të merrni tabletat. Në tешat e përdorura mund të ketë mbetje të lëkurës ose parazitë të skabies.

Përdorni peshqirë të pastër dhe vishni rroba të pastra për të paktën 4 ditë pas trajtimit. Përveç kësaj, ndërroni tешat e shtratit në mëngjesin pas trajtimit.

Larja e duhur

Tешat e shtratit dhe peshqirët dhe rrobat e përdorura në 4 ditët e fundit duhet të lahen në lavatriçe në të paktën 60 °C. Të gjitha rrobat që keni veshur dhe që nuk mund të lahen sipas udhëzimeve (të paktën 60 °C), gjithashtu dhe objektet që kanë qenë në kontakt të gjatë me trupin tuaj (si mansheta e matjes së tensionit të gjakut, këpucët, lodrat prej pelushi, etj.) duhet të ruhen për 72 orë në një qese plastike, të cilën duhet ta mbyllni mirë dhe ta ruani në një vend të thatë dhe të ngrohtë (të paktën 21°C).

Veshjet që nuk mund të lahen në 60 °C ju gjithashtu mund t'i çoni në pastrim kimik. Tешat e pastra dhe të freskëta mund t' i përdorni pa hezitim.

Sende të tjera

Dyshekët, mobilet me veshje, jastëkët dhe tapetet duhet të pastrohen një herë tërësisht me fshesë me korrent (tepër e domosdoshme që më pas të ndërroni filtrin ose ta pastroni rrënjësisht). Të gjitha dyshemetë dhe mobilet e tjera duhet të pastrohen me leckë të lagur.

Përdorimi i pesticideve (pesticideve ose insekticideve) në ambientet e shtëpisë nuk është as i dobishëm dhe as i përshtatshëm. Dezinfektuesit janë krejtësisht të paefektshëm kundër parazitëve të zgjebes.

Si duhet të veproni meoemos në ditët pas trajtimit?

Zakonisht, një trajtim i vetëm me tableta ivermectin-biomo 3 mg është i mjaftueshëm. Kruajtja tipike nga infektimi me parazitët e skabies zgjat zakonisht nga disa ditë deri në disa javë.

Gjatë kësaj periudhe, mund të merrni masa për trajtimin e lëkurës për të lehtësuar kruajtjen (p.sh. duke përdorur kremra hidratues). Nëse kruajtja është shumë e rëndë, mjeku mund t' ju jap edhe preparate kundër kruajtjes.

A duhet të trajtohen edhe personat me të cilët keni kontakt?

Personat që jetojnë në të njëjtën banesë, pra zakonisht të gjithë anëtarët e familjes dhe të gjithë kontaktet e tjera të afërta, duhet patjetër të trajtohen gjithashtu, pavarësisht nëse kanë ose nuk kanë simptoma të tilla, si ndryshime të lëkurës ose kruajtje. Mjeku juaj duhet të përcaktojë se kush ka nevojë për trajtim.

Informacion: Përmbajtja e kësaj broshure shërben vetëm për informacion dhe nuk mund të zëvendësojë në asnjë mënyrë këshillën mjekësore. Nëse keni pyetje specifike, ju lutemi konsultohuni me mjekun tuaj.



Josef-Dietzgen-Straße 3
53773 Hennef
Telefon 0 22 42 87 40-0
Fax 0 22 42 87 40-499

www.biomopharma.de
biomo@biomopharma.de



Këshillat tona për terapinë janë gjithashtu në dispozicion
www.biomopharma.de gati për shkarkim.